

Komisioni i Ligjeve

KUVENDI
NR. 3968 DATE 21.12.23



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 4800 prot.

Tiranë, më 20.12.2023

Lënda: Kërkesë për mbështetje të iniciativës ligjvënëse.

Drejtuar:

SH.S.ZNJ. LINDITA NIKOLLA, KRYETAR ✓
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SH.T.Z. EDI RAMA, KRYEMINISTËR
KRYEMINISTRIA

Z. ULSI MANJA, MINISTËR
MINISTRIA E DREJTËSISË

Për dijëni:

SH.T.Z. SILVIO GONZATO, AMBASADOR
DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN

SH.T.Z. DAVID WISNER, CHARGE D'AFFAIRES
AMBASADA E SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT

Këtu

Të nderuar,

Tashmë Reforma në Drejtësi ka avancuar në implementimin e saj, paralelisht me të, progres të qëndrueshëm ka shënuar edhe Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, si shkalla e parë e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Edhe në Progres-Raportin e fundit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, ku një ndër kontribuesit kryesorë për kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat Themelore të Njeriut" është edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vlerësohet pozitivisht progresi i arritur bazuar në rezultatet konkrete të punës së KPK-së, porë kjo jo vetëm në aspektin statistikor, por edhe atë të standardeve dhe parimeve kushtetuese ligjore, që u garantojnë subjekteve të rivlerësimit, të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Bazuar edhe në Vendimin nr. 736, të Këshillit të Ministrave, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës", Nënkapitulli i I^{nt}, "Reforma në Drejtësi", i Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", në funksion të konsolidimit të Reformës në Drejtësi, shteti shqiptar garanton ndër të tjera "Mbajtjen e burimeve njerëzore të kualifikuara të zhvilluara nga institucionet e rivlerësimit, pas vitit 2024 e në vazhdim".

Tashmë kur jemi në fund të vitit 2023 dhe Komisionit i mbetet edhe një vit nga mbarimi i mandatit kushtetues¹, angazhimi dhe objektivi ynë është që këtë proces ta përmbyllim plotësisht, përpara afatit të përcaktuar nga Kushtetuta, për të 805 subjektet e rivlerësimit kalimtar.

Referuar statistikave tona zyrtare deri më sot, 18.12.2023, nga 805 subjekte gjithsej, janë rivlerësuar me vendim të KPK-së, 718 subjekte rivlerësimi, ose 89%, nga 90% që është objektivi ynë deri në 31 dhjetor 2023².

Ndërsa për vitin 2024, angazhimi ynë është, që më herët se sa data 31 dhjetor 2024, të përfundojmë plotësisht vetingun edhe për 10% të subjekteve të mbetur të cilët janë duke iu nënshtruar këtij procesi. Kjo me qëllim që, vendimet të arsyetohen me shkrim nga trupat gjykuese dhe t'u njoftohen palëve, duke u garantuar subjekteve dhe Komisionerëve Publikë të drejtën e një ankimi efektiv ndaj vendimeve të Komisionit e më pas t'i përcillen për shqyrtim Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si shkallë e dytë e përfundimtare e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Por duke qenë se viti 2024 është viti i fundit i mandatit tonë, shqetësim mbetet mungesa e rregullimit ligjor të statusit të komisionerëve pas mbarimit të këtij mandati, çka passjell pasiguri juridike dhe asnjë garanci ligjore personale të anëtarëve të këtyre institucioneve kushtetuese, sikurse Kushtetuta ua njeh gjatë ushtrimit të duke i barasvlerësuar në status me anëtarin e Gjykatës së Lartë.

Dëshirojmë të risjellim në vëmendjen Tuaj se këtë qëndrim zyrtar, Komisioni jua ka bërë të njohur edhe në mars të këtij viti, së bashku me Institucionin e Komisionerëve Publikë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e kemi përcjellë si një qëndrim të unifikuar mes KPK-së dhe

¹Me ligjin nr. 16/2022, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më datë 10.2.2022, në nenin 179/b, pika 8 e saj, mandati i komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të Komisionerëve Publikë përfundon më datë 31 dhjetor 2024.

² Pra jemi 1 % afer objektit të këtij viti, për të rivlerësuar deri më 31 dhjetor 2023, 90 % të listës ex-officio të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Institucionit të Komisionerëve Publikë, pasi mandati i anëtarëve të këtyre dy institucioneve përfundon njëkohësisht më 31.12.2024.

Duke iu përmbajtur kërkesave që Ju janë parashtruar edhe më herët nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, që prej vitit 2019 - 2021, në frymën e bashkëpunimit institucional, lutemi gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese një relacion të gjerë e të argumentuar për ndryshimet ligjore që propozojmë të iniciohen nga organet kompetente dhe ligjvënëse, pjesë e kalendarit të projektakteve të vitit 2024 të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit të Ministrave dhe të Kuvendit të Shqipërisë, ndryshime të cilat synojnë garantimin e statusit të komisionerëve, të këshilltarëve të njësisë ligjore dhe të stafit administrativ të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Me besimin se kërkesat tona legjitime do të gjejnë mbështetje, me lejon qe, në emër të gjithë anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit t'Ju shpreh gjithë vullnetin tonë për të siguruar finalizimin me sukses të këtij procesi historik për konsolidimin e Shtetit të së Drejtës në vendin tonë dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e reja të drejtësisë.

Me konsideratë,

KRYETAR

Roland ILIA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

RELACION

PËR PROPOZIMIN E DRAFT-LIGJEVE TË PAKETËS LIGJORE TË REFORMËS NË DREJTËSI PËR ANËTARËT E KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

• **Mbi statusin e Komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

Në nenin 179/b, paragrafi i parë, të Kushtetutës, sanksionohet objekti i këtij procesi: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”. Rëndësi të posaçme i ka kushtuar Kushtetuta dhe rregullimit të vijimësisë së trajtimit të çështjeve që lidhen me rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas përfundimit të mandatit të lartpërmendur për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit.

Ndërkohë kompetenca e Komisionerëve Publikë pas përfundimit të mandatit të tyre, do të ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme antikorrupsion (SPAK).

Si pjesë integrale e Kushtetutës, aneksi i saj në 10 nene ka bërë një detajim të mëtejshëm të objektivave, kritereve dhe mënyrës në të cilën do të kryhet procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Një rregullim të posaçëm, neni C i Aneksit të Kushtetutës parashikon ndër të tjera edhe statusin që gëzojnë anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre kushtetues.

Mbështetur në depozitën e nenit C të Aneksit të Kushtetutës, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

Edhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka bërë një detajim edhe më konkret të garancive që Kushtetuta u ka njohur institucioneve të rivlerësimit në kryerjen e funksionit të tyre, të tilla që kanë të bëjnë me miratimin e strukturës nga Kuvendi i Shqipërisë, hartimin e një buxheti të pavarur, ofrimin e mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe pasurisë, pagesës sipas statusit që gëzojnë dhe përfitimin e një pagese shtesë për shkak të vështirësisë së funksionit.

Të gjitha këto garanci që Kushtetuta i njeh anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, janë pasqyrim i nevojës thelbësore që këto institucione të funksionojnë të pavarura, pa asnjë ndikim në ushtrimin e detyrës nga degët e pushtetit shtetëror, të garantimit të integritetit të tyre profesional dhe personal.

Këto element, që në përmbajtje pasqyrojnë garancitë që doktrina kushtetuese ka parashikuar si garanci për ekzistencën e pavarësisë së institucioneve në kryerjen e funksioneve të tyre kushtetuese,

kanë gjetur shprehje dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ndër vite dhe atë të GJEDNJ-së.

Në analizë të elementëve që sigurojnë pavarësinë në funksionimin e njëres degë të pushtetit, pushtetit gjyqësor, në vendimin nr. 11/2010 të Gjykatës Kushtetuese interpretohet se “23. Në vlerësimin e Gjykatës, pavarësia e gjyqësorit kuptohet si **pavarësi substanciale**, që do të thotë “liri e gjykatave për të dhënë vendime, të cilat nuk bazohen në interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit”; **pavarësi strukturale** që lidhet me parashikimin në Kushtetutë apo në ligj të ekzistencës së institucionit, të mënyrës së formimit të përbërjes së tij; **pavarësi organizative** që përfshin strukturimin e brendshëm administrativ të gjykatave; **pavarësi financiare** që nënkupton autonomi në hartimin e buxhetit nga vetë institucioni dhe miratimin nga legjislativi, si një zë i veçantë i buxhetit, fonde të përshtatshme e të mjaftueshme për të realizuar qëllimin dhe detyrat e institucionit e sovranitetit në lidhje me administrimin e fondeve të akorduara; si dhe **pavarësi personale**, që kërkon emërim në bazë të kriterëve objektive, imunitet, garanci ekonomike, garanci për karrierën, sistem të transferimit dhe një sistem disiplinor.”

Ndërkohë që garancitë për pavarësinë substanciale, atë strukturale, organizative dhe financiare të parashikuara në Kushtetutë për institucionet e rivlerësimit, kanë gjetur pasqyrim dhe ligj, garancitë për pavarësinë personale, e veçanërisht, ato që lidhen me vijimësinë e karrierës profesionale të anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk janë gjetur pasqyrim.

Në garantim të karrierës profesionale, si element i pavarësisë personale të gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit, ligjvënësi, ka parashikur që pas mbarimit të mandatit të tyre 9 vjeçar, përgjatë të cilit ata gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët e këtij Kolegji të emërohen gjyqtarë në nivel apeli. Kjo parashikohet në paragrafin 6, të nenit 166, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ky element thelbësor i pavarësisë personale, garancia e karrierës profesionale, konstatohet se nuk është parashikuar për anëtarët e dy institucioneve të tjera të rivlerësimit, përkatësisht komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë, duke cënuar kështu parimin e sigurisë juridike për anëtarët që kanë dhënë e vijnë të japin kontribut në procesin kushtetues të rivlerësimit.

Edhe pse Kushtetuta u njeht gjatë mandatit komisionerëve, statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, nuk rezulton që e njëjta garanci për karrierën që u është sanksionuar në ligj anëtarëve të Kolegjit të Apelit, të jetë sanksionuar edhe për këta anëtarë të dy institucioneve të tjera të rivlerësimit, duke lënë një vakum në garantimin e pavarësisë personale të këtyre subjekteve gjatë ushtrimit të funksionit të tyre kushtetues.

Edhe po t’i referohemi për analogji, statusit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, që iu njeht Kushtetuta komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë, paragrafi 4 i nenit 61 të ligjit nr. 96/2018 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar shprehimisht të drejtën e anëtarëve të Gjykatës së Lartë për t’u emëruar në një pozicion të magistratit në nivel apeli, para përfundimit të mandatit.

Pra, edhe referenca në statusin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, që Kushtetuta iu njeht komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë, duhet ta shtyjë ligjvënësin që të njëjtën garanci për karrierë në përfundim të mandatit që iu është njohur anëtarëve të Kolegjit të Apelit, si institucion rivlerësimi, t’ua sigurojë dhe komisionerëve të

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerëve Publikë, duke garantuar kështu dhe pavarësinë personale të të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit gjatë kryerjes së funksionit të tyre.

Që nga zgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit me vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është duke u zbatuar dhe ka dhënë rezultatet e tij të para pozitive, në bashkëpunim të ngushtë me vëzhguesit ndërkombëtar të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Referuar edhe vendimit të GJEDNJ-së, Nr. 15227/19, datë 9.2.2021, "Çështja XHOXHAJ k. SHQIPËRISË", ndër të tjera shprehet se: "... Kriteret për emërim në KPK dhe KPA duket se janë të barasvlefshme me kriteret e emërtimeve në gjyqësor dhe, së paku duken po aq të rrepta sa ato në fuqi për emërimet në detyrë të përhershme gjyqësore. ...Përveç faktit që këto nuk do të ishin institucione të përhershme, duket se qëllimi i parashikimeve kushtetuese dhe ligjore ishte t'u jepte atyre karakteristika kryesore të gjykatave. Pas përfundimit të mandatit të tyre, çdo çështje në pritje për t'u gjykuar, në vijim, do të shqyrtohet nga institucionet e përhershme gjyqësore dhe të prokurorisë.

...Për më tepër, institucionet e rivlerësimit funksionojnë mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe parimet e tjera që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit. Ata zbatojnë edhe parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative dhe ligjit për gjykatat administrative. Për më tepër, ligji nr. 84/2016 ka parashikuar garantimin dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit."

Duke marrë në konsideratë rezultatet e punës mbi 5-vjeçare të KPK-së, si një organ rivlerësi quasi gjyqësor, kriteret e caktimit të tyre dhe eksperiencën e fituar, si dhe konsolidimin e standardeve të procedurave hetimore dhe të vendimmarrjes, paanshmërinë dhe pavarësinë e tyre në ushtrimin e detyrës për një mandat 7.5- vjeçar të pandërprerë, do të ishte legjitim që kontributi i tyre të mos shterojë me përfundimin e procesit të rivlerësimit, por ata të caktohen gjyqtarë në nivel apeli, sikurse anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Në frymën e parimeve dhe standardeve të Bashkimit Evropian, si dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së apo GJED të BE-së, sa i takon çështjeve të sistemit gjyqësor dhe funksionarëve apo gjyqtarëve që caktohen/ emërohen me ligj e që kontribuojnë me profesionalizëm dhe integritet në ushtrimin e detyrës, atyre duhet t'u njihen dhe vlerësohen kontributet, duke i integruar brenda sistemit gjyqësor me meritë dhe objektivitet.

Për të gjitha këto argumenta, përmbushja nga ligjvënësi i të gjitha garancive që mundësojnë pavarësinë e anëtarëve të institucionit të rivlerësimit, përfshirë pavarësinë personale të tyre dhe vijmësinë e karrierës, duhet të gjejë pasqyrim në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Konkretisht në nenin 166, pika 6 e tij propozohet të ndryshohet sipas këtij riformulimi:

"6. Anëtari i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, anëtari i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerët Publikë emërohen si gjyqtarë në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës".

- Mbi statusin e këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe stafit administrativ

Në ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim referuar "ligji nr. 84/2016"), neni 29, pika 6 parashikon: "*Pas përfundimit të mandatit të institucioneve të rivlerësimit, këshilltari ligjor dhe ekonomik, me pëlqimin e tij/saj, ka të drejtë të emërohet në funksionin ose detyrën publike që kishte para zgjedhjes së tij/saj ose në një vend të përafërt në administratën publike.*"

Megjithëse qëllimi i kësaj dispozite ka qënë për të garantuar kthimin në funksionet dhe detyrat e mëparshme të këshilltarëve ligjorë dhe ekonomikë, mendojmë se ky parashikim do të jetë i vështirë për t'u zbatuar në praktikë pasi dispozita nuk është e qartë për sa u përket modaliteteve se si do të realizohen kthimi në detyrë. Parashikimi i saj do të shtrihet vetëm për një numër tejet të kufizuar të këshilltarëve, të cilët kanë qënë pjesë e administratës publike, vendet e mëparshme të të cilëve janë zvëndësuar ose afati i pezullimit të statusit të nëpunësit civil ka përfunduar, ndërsa një pjesë e këshilltarëve vijnë nga sektori privat, dhe vendet e punës nga të cilat janë larguar janë të zëna; Të ndodhur në kushtet e kësaj dispozite, këshilltari i Njesisë së Shërbimit Ligjor do të gjendej në kushte të barabarta me një subjekt rivlerësimi i cili pas procesit të rivlerësimit është shkarkuar, ndërkohë që ky proces kurrësi nuk mund të prodhojë barazi mes personave të shkarkuar dhe atyre që kanë ndihmuar në kryerjen e procesit të tyre të rivlerësimit. Gjithashtu, sa i takon punonjësve administrativë në ligjin nr. 84/2016 nuk ka asnjë parashikim në drejtim të mbrojtjes dhe garantimit të vazhdimësisë së marrëdhënieve të punës lidhur me këtë kategori.

Në fillimet e saj, në nëntor 2017, struktura e Njesisë së Shërbimit Ligjor, përbëhej nga 12 këshilltarë ligjor dhe 4 këshilltarë ekonomik të miratuar nga Kuvendi nr. 93/2017. Që nga fillimi i mandatit të Komisionit ushtrojnë detyrën pa ndërprerje 7 këshilltarë ligjorë, që aktualisht janë në detyrë prej më shumë se 5 vitesh.

Me vendimet nr. 100/2018 dhe nr. 83/2020, Kuvendi vendosi të shtojë organikën e Komisionit me 8 këshilltarë ekonomikë dhe 12 këshilltarë ligjorë. Gjatë kësaj periudhe ka pasur largime por edhe rekrutime të reja për zëvendësimin e këshilltarëve të cilët janë larguar. Konkretisht, në fund të vitit 2018, dhe gjatë vitit 2019, në muaj të ndryshëm, u zëvendësuan 3 këshilltarë ligjorë dhe u shtuan 8 këshilltarë ekonomikë, të cilat aktualisht ushtrojnë detyrën prej më shumë se 3 vitesh. Pjesa tjetër prej 17 këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë u shtuan dhe ushtrojnë detyrën prej vitit 2020, e në vijim. Aktualisht, Njësia e Shërbimit Ligjor funksionon me 36 këshilltarë. Këshilltarët e rekrutuar, si ata ligjorë apo ekonomikë, kanë një përvojë si nga administrata publike ashtu dhe nga sektori privat. Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, vijnë si një përzgjedhje e kandidatave më të mira të paraqitura, dhe që mbartin një përvojë shumëvjeçare nga institucione të rëndësishme publike, sistemi i drejtësisë, sistemi bankar, avokatia etj. Duke i shtuar kësaj përvoje, edhe eksperiencën tashmë më shumë se 6 vjeçare të angazhimit të tyre pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mendojmë se ata kanë krijuar një personalitet dhe fizionomi thuajse të ngjashme me profesionistët e vetë sistemit, dhe se përthithja e kësaj kategorie do të ishte dobiprurëse, dhe një vlerë e shtuar për sistemin e ri të krijuar.

Në më shumë se 6 vite të aktivitetit të institucionit, Këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, dhe punonjësit administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kanë qënë një hallkë kyçe dhe me ndikim esencial në veprimtarinë e këtij institucioni. Këta punonjës, janë përballur dhe kanë mbështetur sfidat dhe vështirësitë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në tërësi, si dhe kanë kryer me sukses, integritet dhe profesionalizëm detyrat e përcaktuara në ligj. Këta persona kanë punuar e jetuar me kufizimet kushtetuese dhe ligjore që vendi i punës u dikton,

duke iu nënshtruar së bashku me familjarët e tyre, kufizimeve të posaçme të së drejtës së fshehtësisë së komunikimeve, monitorimit sistematik të llogarive dhe transaksioneve financiare si dhe kontrollit vjetor të pasurisë përgjatë ushtrimit të detyrës dhe deri në tre vjet pas përfundimit të saj.

Personeli i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka qenë dhe vazhdon të jetë kontributor dhe përfaqësues i institucioneve të rivlerësimit, në takimet në kuadër të proceseve integruese të Shqipërisë, në Bashkimin Evropian.

Për të gjitha këto arsye,

-Duke pranuar nivelin e lartë profesional dhe etik të këshilltarëve dhe punonjësve administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

-Të ndodhur përballë detyrimit kushtetues të mandatit të kufizuar të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit;

-Në mungesë të garancive ligjore për vazhdimësinë e karrierës së këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe punonjësve administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, fakt i cili e ka përballur dhe vazhdon të përballë këtë institucion me largime të punonjësve dhe vështirësi në rekrutimet e reja, duke rrezikuar në këtë mënyrë përmbushjen në kohë të detyrimeve ligjore e kushtetuese;

-Me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë së karrierës profesionale të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në vijim, po Ju paraqesim propozimet tona si më poshtë:

1. Propozime për disa ndryshime në ligjin nr. 96 /2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

Me qëllim për të garantuar qëndrueshmërinë në detyrë dhe vazhdimësinë e karrierës profesionale, propozohet që këshilltarëve ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përfundim të mandatit kushtetues të këtij institucioni t'u njihet e drejta për t'u bërë pjesë e sistemit gjyqësor e sistemit të prokurorisë, dhe vazhdimin e karrierës në këto sisteme.

Sikurse parashikohet në nenin 179/b të Kushtetutës, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është organi kompetent që kryen procesin e rivlerësimit dhe i vetmi ndër institucionet e rivlerësimit që kryen një proces hetimi administrativ të mirëfilltë dhe në pas vepron si *quasi* gjykatë e shkallës së parë. Në këtë institucion janë krijuar standartet e para të ndjekjes së procedurës hetimore të çdo subjekti rivlerësimi, dhe është formësuar praktika e plotë e punës. Në këtë kontekst, në funksion të ushtrimit të kompetencave të Komisionit, përveç volumit disa herë më të madh se institucionet e tjera të rivlerësimit që prej fillimit të punës së tij, këshilltarët ligjorë të Komisionit kanë ushtruar detyra të karakterit si hetimor në drejtim të mbledhjes së fakteve e provave, ashtu edhe në drejtim të gjyqimit e interpretimit mbi këto fakte e prova.

Këshilltarët ligjorë të Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit referuar përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe Rregullores së veprimtarisë së Komisionit, përbëjnë bërthamën ndihmëse dhe këshillimore që mbështet punën profesionale të komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ata ushtrojnë veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës, duke përfshirë: përgatitjen e çështjeve për gjykim; dhënien e opinioneve ligjore në lidhje me mënyrën se si do të procedohet me gjykimin e çështjes; përgatitjen e relacionit ligjor mbi zgjidhjen e çështjes në themel; hartojnë projektvendimin nën orientimin e komisionerit

që arsyeton vendimin, si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër të caktuar nga relatori i çështjes, apo anëtarët e trupit gjykues.

Më konkretisht, këshilltari ligjor i Njesisë së Shërbimit Ligjor, në kuadër të këtij procesi të veçantë hetimor administrativ dhe *quasi* gjyqësor, ka hetuar, vlerësuar dhe ka dhënë opinione mbi çështje të caktuara, të hetuara apo gjykuara më parë nga gjyqtarë apo prokurorë. Për efekt të rivlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit, për përgatitjen e relacioneve, janë analizuar dosje gjyqësore e penale, vendime të dhëna nga subjektet e rivlerësimit në të gjitha shkallët e gjyqësorit, dhe Gjykatën Kushtetuese. Është analizuar procedura e ndjekur gjatë hetimit apo gjykimit nga subjektet e rivlerësimit në ushtrimin e funksioneve të tyre deri në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Analizimi i çështjeve të relatuara me të cilat këshilltarët janë përballur dhe kanë mundur të debatojnë me seriozitet, ka qenë dhe është një proces delikat, impenjativ, hulumtues dhe studimor në shumë legjislacione vendase dhe të huaja.

Në procesin e punë së rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit, në relacionet e hartuara nga këshilltarët për çdo çështje e cila më tej është shqyrtuar nga Komisionerët nën mbikëqyrjen e vëzhguesve ndërkombëtar, është arsyetuar mbi legjislacion, rregullore e urdhërime që rregullojnë e dispiplinojnë fusha të caktuara në sistemin e drejtësisë, por edhe janë reflektuar praktikata e mira gjyqësore, çka tregon se tanimë në rolin dhe punën e këshilltarit është kultivuar e rritur niveli profesional. Mjafton të përmendim që vetëm në Raportin Statistikor të Komisionit, për periudhën 8 shkurt 2018 - në 18 dhjetor 2023, nga këshilltarët Njesisë së Shërbimit Ligjor janë përpiluar qindar relacione, për të cilët më tej janë dhënë 718 vendime gjithsej.

Risjellim në vëmendje që, si pasojë e parashikimeve ligjore në fuqi procedurat e përzgjedhjes dhe rekrutimit të këshilltarëve ligjorë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të cilat bazohen në kriteret transparente, objektive dhe meritës si: eksperiencia minimalisht 7 vjeçare në sistemin e drejtësisë ose administratën publike, kualifikimet, integriteti, aftësitë profesionale, pastërtia e figurës dhe disiplina në ushtrimin e detyrës vlerësohen se janë në harmoni, madje më rigoroz se kërkesat e ligjit për vlerësimin paraprak të kandidatëve për magistratë nga Shkolla e Magistraturës dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor/ Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Për këto arsye mund të çmohet si i panevojshëm vlerësimi i këtyre kandidatëve (këshilltarëve ligjorë të Komisionit) për t'u pranuar në formimin fillestar pranë Shkollës së Magistraturës nëpërmjet konkurimit. Për rrjedhojë propozohet që të gjithë këshilltarët ligjorë që kanë ushtruar detyrën e tyre për një periudhë jo më pak se 5 vite në Komision, pas mbarimit të mandatit të institucionit të kenë të drejtën të pranohen në programin e formimit fillestar të profilit "gjyqtar/ prokuror" të Shkollës së Magistraturës pa iu nënshtruar konkurimit.

E drejta për t'u pranuar në programin e formimit fillestar realizohet nëpërmjet shprehjes së interesit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili nevojitet të marrë masat për përfshirjen e këtyre kandidatëve në numrin total të kandidatëve magistratë të profilit "gjyqtar/ prokuror" për vitin akademik që i përket vitit të fundit të përfundimit të mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (dhjetor 2024), në përputhje me kërkesat e nenit 29 të ligjit.

Programi i formimit fillestar për këtë kategori kandidatësh, duke marrë parasysh argumentet e dhëna më sipër, propozohet të jetë i posaçëm, me kohëzgjatje totale 1-vjeçare, me fokus rritjen e aftësive praktike të kandidatëve si gjyqtarë/ prokurorë, për sa kohë rritja e njohurive teorike në lëndë të ndryshme të së drejtës çmohet i përmbushur në kontekst të një eksperience profesionale shumëvjeçare të këtyre kandidatëve në fushën e së drejtës.

Vlerësimi dhe renditja e këtyre kandidatëve për magjistratë propozohet të kryhet sipas një provimi përfundimtar, nëpërmjet të cilit të testohet niveli i njohurive teorike si dhe kryhet vlerësimi etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Ky parashikim ligjor përmbush kërkesat e nenit 136/a dhe 148/ç të Kushtetutës sipas të cilit gjyqtarë/ prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, duke garantuar njëkohësisht barazinë në vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë sipas nenit 268, pika 2 e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Një qasje e ngjashme vihet re të jetë aplikuar në kuadër të një regjimi tranzitor në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e cila u njohu të drejtën për të ndjekur karrierën e magjistratit sipas parashikimeve të posaçme ligjore këshilltarëve në Gjykatën Kushtetuese, në Gjykatën e Lartë dhe gjykatat administrative, si dhe ndihmësave ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, të cilët ishin në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sikundër edhe ish-këshilltarëve të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të cilët kishin të paktën 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës duke përfshirë të paktën 3 vjet si këshilltar. Synimi i ligjvënësisë ishte rekrutimi në sistemin e drejtësisë i juristëve që vinin nga një përvojë disa vjeçare në sistem, të cilët mund të fillonin dhe zhvillonin karrierën e tyre si magjistratë.

Për të gjitha sa më sipër, për këshilltarët ligjorë që kanë ushtruar detyrën për më shumë se 5 vite, propozohet dispozita tranzitore me përmbajtje si vijon:

Neni 1

Pas nenit 165, shtohet neni 165/1 me përmbajtje si më poshtë:

Neni 165/1

Dispozitë kalimtare për këshilltarët ligjorë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Këshilltari ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili ka ushtruar për më shumë se 5 (pesë) vite këtë detyrë, në përfundim të mandatit të institucionit ka të drejtë të pranohet në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratë në profilin "gjyqtar/prokuror" pa iu nënshtruar konkurimit/provimin, pasi të ketë kaluar me sukses vlerësimin psikologjik dhe të shëndetit mendor, sipas procedurës së parashikuar në ligj. Shprehja e interesit nga subjektet e këtij neni për t'u pranuar në programin e formimit fillestar, në vitin e ri akademik të përfundimit të mandatit të institucionit të rivlerësimit depozitohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili në përputhje me kërkesat e nenit 29 të këtij ligji, përcakton dhe publikon numrin maksimal të kandidatëve magjistratë të profilit "gjyqtar /prokuror" pas përfshirjes së kandidatëve të interesuar sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Programi i formimit fillestar për subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ka kohëzgjatje 1 vjeçare dhe përbëhet nga:

- a. 6 muaj program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë/prokurorë nën kujdesin e Shkollës së Magjistraturës dhe nën drejtimin e një gjyqtari/prokurori me kualifikim të lartë;
- b. 6 muaj praktikë profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në këtë ligj.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, gjatë periudhës së formimit fillestar përfitojnë pagë të barabartë me pagën e këshilltarit ligjor jomagjistrat sipas parashikimeve të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

4. Në përfundim të programimit të formimit fillestar sipas pikës 2 të këtij neni, subjektet e përcaktuara në pikën 1 më sipër i nënshtrohen një provimi përfundimtar, nëpërmjet të cilit testohet niveli i njohurive teorike si dhe kryhet vlerësimi etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Renditja e kandidatëve për magjistratë sipas këtij neni bëhet mbi bazën e rezultateve të provimit përfundimtar.

Propozim alternativ

Neni 165/1

Dispozitë kalimtare për këshilltarët ligjorë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Këshilltari ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili ka ushtruar për më shumë se 5 (pesë) vite këtë detyrë, në përfundim të mandatit të institucionit ka të drejtë të pranohet në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistrat në profilin, "gjyqtar/prokuror" pa iu nënshtuar konkurrimit/provimit, pasi të ketë kaluar me sukses vlerësimin psikologjik dhe të shëndetit mendor, sipas procedurës së parashikuar në ligj. Shprehja e interesit nga subjektet e këtij neni për tu pranuar në programin e formimit fillestar, në vitin e ri akademik të përfundimit të mandatit të institucionit të rivlerësimit depozitohet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili në përputhje me kërkesat e nenit 29 të këtij ligji, përcakton dhe publikon numrin maksimal të kandidatëve magjistratë të profilit "gjyqtar" pas përfshirjes së kandidatëve të interesuar sipas parashikimeve të këtij neni. Kjo kategori gjatë periudhës së formimit fillestar përfiton pagë të barabartë me pagën e këshilltarit ligjor jomagjistrat sipas parashikimeve të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

2. *Propozime për një ndryshim në ligjin nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".*

Në vijim të analizës së mësipërme, të eksperiencës profesionale dhe natyrës së veçantë të punës së kryer nga këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vlerësohet se ky kontingjent mund të përfshihet natyrshëm dhe të ofrojë ekspertizën e përfituar edhe pranë institucioneve që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, si Byroja Kombëtare e Hetimit. Për këtë qëllim propozohet që këshilltarët të cilët kanë një eksperiencë pune në këtë pozicion për më shumë se 4 (katër) vite, me pëlqimin e tyre të emërohen si hetues pranë Byrosë

Kombëtare të Hetimit pa iu nënshtruar procedurave përzgjedhëse të rekrutimit sipas kriterëve të nenit 38, pika 1, shkronja "ç" dhe pika 2 e ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Në këtë rast prioritet në rekrutim do të kenë këshilltarët me më shumë vjetërsi në përfundim të mandatit të institucionit. Në vijim të sa më sipër, propozojmë që në ligjin nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", të bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 57, pas pikës 13 shtohet pika 14 me përmbajtje si më poshtë:

"14. Përfundimisht nga parashikimi i nenit 37, pika 2, këshilltari pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili ka kryer këtë detyrë për më shumë se 4 (katër) vite dhe plotëson kërkesat e nenit 38, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", në përfundim të mandatit kushtetues të këtij institucioni, me pëlqimin e tij emërohet si hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, pasi të ketë dhënë më parë pëlqimin për t'iu nënshtruar testit të poligrafit rreth integritetit të tij."

3. Propozime "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar".

Propozimet për ndryshime në këtë ligj kanë si qëllim garantimin e qëndrueshmërisë në detyrë dhe vazhdimësisë në shërbimin civil të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili është kontributor në realizimin dhe përmbylljen me sukses të reformës më të rëndësishme të ndërmarrë në sistemin e drejtësisë në vend.

Struktura e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 93/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit", i ndryshuar me vendimet e Kuvendit nr. 100/2018, nr.83/2020 dhe nr.36/2022.

Referuar dispozitave të ligjit nr. 84/2016 personeli i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit përbëhet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë. Procesi i rekrutimit të punonjësve administrativë kryhet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj, si dhe në aktet nënligjore të miratuara nga vetë institucioni dhe udhëhiqet nga parimi i shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës dhe profesionalizmit.

Për vetë rëndësinë e posaçme të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke marrë në konsideratë gamën e gjerë të çështjeve për trajtim në kuadër të procedurave për verifikimin dhe vlerësimin e subjekteve sipas tre shtyllave të procesit të rivlerësimit në kontekstin e parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, me qëllim përballimin me sukses të sfidave të procesit dhe përmbushjes së detyrave janë miratuar kritere specifike për rekrutimin e personelit të Komisionit, të cilat tejkalojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të rekrutimit të punonjësve civilë.

Nëse marrim në analizë kriterin e vjetërsisë në punë, konstatohet se për punonjësit ekzekutivë të punësuar në Komision kërkohet një eksperiencë pune nga 1-3 vjet, në varësi të pozicionit,

përkundrejt një niveli minimal vjetërsie për një punonjës të së njëjtës kategori të shërbimit civil prej 1 viti. Ndërkohë për kategorinë e Drejtorit të Drejtorisë kriteri minimal i vjetërsisë në punë në KPK përcaktohet 5 vjet, përkundrejt mesatarisht 3 vjet për një nëpunës civil, të të njëjtës kategori. Gjithashtu, për nivelin më të lartë të drejtimit administrativ Sekretarin e Përgjithshëm dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, kriteri ligjor i eksperiencës në punë është përcaktuar respektivisht minimalisht 10 dhe 7 vjet, kundrejt një kriteri mesatar prej 3 vitesh eksperiencë pune në shërbimin civil.

Në kuadër të natyrës së veçantë të veprimtarisë së institucioneve të rivlerësimit në kontrast me institucionet e administratës publike, përveç kriterëve të përgjithshme e të posaçme që kanë të bëjnë me arsimin, njohuritë, aftësitë dhe eksperiencën në punë, një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe pastërtisë së figurës së të gjithë personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 28, të ligjit nr. 84/2016, ku citohet: "...anëtar i institucionit të rivlerësimit dhe personeli i tyre trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale", të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror' ", të ndryshuar, dhe VKM-së nr.188, datë 04.03.2015, "Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit", i gjithë personeli i institucioneve të rivlerësimit kalimtar, është pajisur me "Certifikatë Sigurimi Personeli" të niveleve të ndryshme.

Bazuar në këtë ligj, institucionet e rivlerësimit, kanë miratuar dhe zbatojnë rregullore akte normative me të cilat përcaktohet marrëdhënia e punësimit të punonjësve, përshkrimet e punës, rregulla mbi etikën dhe shmangien e konfliktit të interesave, te drejta dhe detyrime, rregullore për vlerësimin e performancës, përgjegjësitë dhe masat disiplinore, rregulla për krijimin dhe administrimin e dosjeve të personelit, në të cilat gjejnë zbatim edhe të drejtat dhe detyrimet në këtë drejtim, të përcaktuara në ligjin për shërbimin civil apo aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Për gjithë argumentet e paraqitura, tashmë në vitin e gjashtë të funksionimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është e pranuar që punonjësit e punësuar në këtë institucion, zotërojnë njohuri dhe aftësi të larta profesionale, me një eksperiencë pune relativisht të gjatë, dhe janë rekrutuar sipas një procedure ligjore konkurruese, të hapur dhe transparente për publikun dhe aplikantët.

Standardi profesional i arritur gjatë eksperiencës së deritanishme të punës në Komisionin e pavarur të Kualifikimit duhet ruajtur dhe motivuar, për të garantuar cilësinë e shërbimit, profesionalizmin dhe qëndrueshmërinë në përmbushjen e misionit kushtetues të institucionit dhe në vijim të vihen në funksion të shërbimit civil në të ardhmen.

Këtij qëllimi i shërbejnë dhe propozimet për ndryshime në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", që paraqitet me shtesën e një dispozite kalimtare si dhe një ndryshimi në nenin 27 të ligjit aktual.

Dispozita kalimtare parashikon që këshilltarët e Njesisë së Shërbimit ligjor dhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të cilët kanë punuar në këto pozicione jo më pak se 4 vjet, në përfundim të mandatit kushtetues të këtij institucioni, të konsiderohen për shkak të ligjit, nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionet e administratës shtetërore (TND). Në rast se këshilltarët dhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit nuk përmbushin kriterin

e vjetërsisë në pozicion, atëherë ata do të konsiderohen nëpunës të nivelit të mesëm drejtues. Edhe për punonjësit administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, propozohet që në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit, të marrin për shkak të ligjit statusin e nëpunësit civil, sipas kategorisë përkatëse ekzekutive dhe drejtuese.

Propozimi i kësaj dispozite kalimtare duhet të shoqërohet dhe me një ndryshim në nenin 27 të ligjit aktual në të cilin të parashikohet përjashtimi nga rregulli i përgjithshëm për pranimin në Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues nëpërmjet përfundimit të formimit të thelluar në ASPA, për këtë kategori e cila pranohet në TND për shkak të parashikimit ligjor.

Në përfundim, propozojmë që në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në pikën 4 të nenit 27 të ligjit, togfjalëshi “*me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni dhe në nenin 30, pika 5/1, të këtij ligji.*” zëvendësohet me togfjalëshin “*me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni dhe nenet 30, pika 5/1 dhe 67/1, pika 1 e këtij ligji.*”.

Neni 2

Pas nenit 67, shtohet neni 67/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 67/1

Statusi i personelit të institucioneve të rivlerësimit

1. Këshilltari i Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të cilët kanë punuar në këto pozicione jo më pak se katër vite, në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit, konsiderohen për shkak të ligjit, nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e administratës shtetërore dhe emërohen si anëtarë të TND-së. Personat të cilët nuk përmbushin kriterin e vjetërsisë në pozicion, si më sipër, konsiderohen nëpunës të nivelit të mesëm drejtues dhe bëhen pjesë e shërbimit civil.

2. Punonjësit administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të cilët kanë punuar në pozicione të nivelit ekzekutiv jo më pak se një vit dhe të nivelit të mesëm drejtues, jo më pak se tre vite, në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit, marrin për shkak të ligjit statusin e nëpunësit civil, sipas kategorisë përkatëse ekzekutive dhe drejtuese të përcaktuar në vendimet e Kuvendit për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimin e pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

3. Deklarimi i statusit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet nga Njësia Përgjegjëse për Burimet Njerëzore, në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit të rivlerësimit, pas verifikimit të kushteve të përcaktuara në këto pika.

Miratimi i këtij propozimi i jep mundësinë kësaj kategorie, të aplikojnë dhe të jenë pjesë e personelit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, pasi pas ndryshimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të miratuar me ligjin nr. 41/2017, administrata e këtyre institucioneve është pjesë e shërbimit civil.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Draft 1

PROJEKTLIGJ³

NR. ___ /2024

PROJEKTLIGJ

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKUROËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave/ deputeti/ deputetëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 165, shtohet neni 165/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 165/1

Dispozitë kalimtare për këshilltarët ligjorë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

I. Këshilltari ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili ka ushtruar për më shumë se 5 (pesë) vite këtë detyrë, në përfundim të mandatit të institucionit ka të drejtë të pranohet në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magistratë në profilin “gjyqtar/prokuror” pa iu nënshtruar konkurrencës/provimit, pasi të ketë kaluar me sukses vlerësimin psikologjik dhe të shëndetit mendor, sipas procedurës së parashikuar në ligj. Shprehja e interesit nga subjektet e këtij neni për t’u pranuar në programin e formimit fillestar, në vitin e ri akademik pas përfundimit të mandatit të institucionit të rivlerësimit depozitohet pranë Këshillit të Lartë

³Ky draft parashikon rregullimin ligjor të statusit të dy funksioneve, statusin e komisionerëve të KPK-së dhe atë të këshilltarëve të njesisë së shërbimit ligjor në KPK, duke amenduar ligjin nr. 96/2016.

Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili në përputhje me kërkesat e nenit 29 të këtij ligji, përcakton dhe publikon numrin maksimal të kandidatëve magjistratë të profilit "gjyqtar/prokuror" pas përfshirjes së kandidatëve të interesuar sipas parashikimeve të këtij neni.

2. Programi i formimit fillestar për subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ka kohëzgjatje 1 vjeçare dhe përbëhet nga:

c. 6 muaj program praktik paraprofesional, që synon të rrisë aftësitë praktike të kandidatëve si gjyqtarë/prokurorë nën kujdesin e Shkollës së Magjistraturës dhe nën drejtimin e një gjyqtari/prokurori me kualifikim të lartë;

d. 6 muaj praktikë profesionale që do të organizohet sipas mënyrës dhe afateve të parashikuara në këtë ligj.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, gjatë periudhës së formimit fillestar përfitojnë pagë të barabartë me pagën e këshilltarit ligjor jomagjistrat sipas parashikimeve të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

4. Në përfundim të programimit të formimit fillestar sipas pikës 2 të këtij neni, subjektet e përcaktuara në pikën 1 më sipër i nënshtrohen një provimi përfundimtar, nëpërmjet të cilit testohet niveli i njohurive teorike si dhe kryhet vlerësimi etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Renditja e kandidatëve për magjistratë sipas këtij neni bëhet mbi bazën e rezultateve të provimit përfundimtar".

Propozim alternative i Nenit 1 të Projekt-ligjit

"Neni 165/1

Dispozitë kalimtare për këshilltarët ligjorë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Këshilltari ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili ka ushtruar për më shumë se 5 (pesë) vite këtë detyrë, në përfundim të mandatit të institucionit ka të drejtë të pranohet në programin e formimit fillestar të kandidatëve për magjistratat në profilin "gjyqtar/prokuror" pa i'u nënshtuar konkurrencës/provimit, pasi të ketë kaluar me sukses vlerësimin psikologjik dhe të shëndetit mendor, sipas procedurës së parashikuar në ligj. Shprehja e interesit nga subjektet e këtij neni për t'u pranuar në programin e formimit fillestar, në vitin e ri akademik pas përfundimit të mandatit të institucionit të rivlerësimit depozitohen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor/Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili në përputhje me kërkesat e nenit 29 të këtij ligji, përcakton dhe publikon numrin maksimal të kandidatëve magjistratë të profilit "gjyqtar" pas përfshirjes së kandidatëve të interesuar sipas parashikimeve të këtij neni. Kjo kategori gjatë periudhës së formimit fillestar përfiton pagë të barabartë me pagën e këshilltarit ligjor jomagjistrat sipas parashikimeve të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Në nenin 166, pika 6 ndryshohet si vijon:

"6. Anëtarit i Kolegjit të Apelit, anëtarit i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerët Publikë emërohen si gjyqtarë në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
LINDITA NIKOLLA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Draft 2

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

**"PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 95 /2016 "PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR"**

Në mbështetje të nenit 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave/deputeti/deputetëve,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 95 /2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", bëhet shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në neni 57, pas pikës 13 shtohet pika 14 me përmbajtje si më poshtë:

" 14. Përrjashtimisht nga parashikimi i nenit 37, pika 2, këshilltari pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, i cili ka kryer këtë detyrë për më shumë se 4 (katër) vite dhe plotëson kërkesat e nenit 38, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", në përfundim të mandatit kushtetues të këtij institucioni, me pëlqimin e tij emërohet si hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit, pasi të ketë dhënë më parë pëlqimin për t'iu nënshtuar testit të poligrafit rreth integritetit të tij."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

LINDITA NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Draft 3

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 152/2013 "PËR STATUSIN E NËPUNËSIT CIVIL", TË NDRYSHUAR.

Në mbështetje të nenit 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave/deputeti/deputetëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil", të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në pikën 4 të nenit 27 të ligjit, togfialëshi "me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni dhe në nenin 30, pika 5/1, të këtij ligji", zëvendësohet me togfialëshin "me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 5 të këtij neni dhe nenet 30, pika 5/1 dhe 67/1, pika 1 e këtij ligji".

Neni 2

Pas nenit 67, shtohet neni 67/1 me përmbajtje si më poshtë:

"Neni 67/1

Statusi i Njesisë së Shërbimit Ligjor të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

“1. Këshilltari i Njesisë së Shërbimit Ligjor dhe Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të cilët kanë punuar në këto pozicione jo më pak se katër vite, në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit, konsiderohen për shkak të ligjit, nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e administratës shtetërore dhe emërohen si anëtarë të TND-së. Personat të cilët nuk përmbushin kriterin e vjetërsisë në pozicion, si më sipër, konsiderohen nëpunës të nivelit të mesëm drejtues dhe bëhen pjesë e shërbimit civil.

2. Punonjësit administrativë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të cilët kanë punuar në pozicione të nivelit ekzekutiv jo më pak se një vit dhe të nivelit të mesëm drejtues, jo më pak se tre vite, në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit, marrin për shkak të ligjit statusin e nëpunësit civil, sipas kategorisë përkatëse ekzekutive dhe drejtuese të përcaktuar në vendimet e Kuvendit për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimin e pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

3. Deklarimi i statusit, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, bëhet nga Njësia Përgjegjëse për Burimet Njerëzore, në përfundim të mandatit kushtetues të institucionit të rivlerësimit, pas verifikimit të kushteve të përcaktuara në këto pika.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
LINDITA NIKOLLA**

Tiranë, më ___/___/2024